

1.




Shoqata e Bletarëve Nukleus fillon prodhimine dyllit të bletës në komunën e Graçanicës

2.



Hapet qendra e re e karrierës në Viti si rezultat i bashkë-investimit midis SDC, dhe Komunës së Vitisë

3.



'Shkolla Digjitale' nga Kosova nënshkruan marrëveshje me 'Berlitz', një ndër shkollat më të mëdha të gjuhëve në botë, me mundësi të zgjerimit në 500 lokacione të reja në mbarë botën.

4.



Rimëkëmbja nga pandemia: Si po i përgatit furgoni i improvizuar salduesit e ardhshëm në Kosovë



# 1.



## SHOQATA E BLETARËVE NUKLEUS fillon prodhimine dyllit të bletës në komunën e Graçanicës



Këtë javë ishim të lumtur që të shënojmë fillimin e prodhimit të dyllit të bletës në Llapllasellë të komunës së Graçanicës! Bletët janë polenizuesi më i rëndësishëm në botë i kulturave ushqimore. Rreth 1/3 e gjithë ushqimit që konsumojmë çdo ditë mbështetet në polenizim nga bletët. Në Kosovë, ndonëse industria e bletarisë është në rritje e sipër dhe ka një potencial të madh, një ndër pengesat kryesore për bletarët është mungesa e fletëve cilësore të dyllit të bletës, të cilat janë furnizim thelbësor për një prodhim cilësor të mjaltit, qumështit të bletës, propolisit, etj.



**ME 40 ANËTARË QË  
POSEDOJNË  
1,000 KOSHERE BLETËSH**

Shoqata e Bletarëve Nukleus zotëron njohuri të shkëlqyeshme dhe rrjet të gjerë të bashkëpunëtorëve në industrinë e bletarisë në Kosovë. EYE ka mbështetur Nukleus-in në zhvillimin e planit për biznesin e vetë-qëndrueshëm dhe sigurimin e makinave për prodhimin e dyllit të bletës – një intervenim sistematik që do të ndihmojë jo vetëm Nukleus-in, por edhe tërë ekosistemin e bletarëve në Kosovë, në kuadër të së cilit vlerësohet të jenë gjithsej 100,000 koshere bletësh, që mund të shfrytëzojnë dyllin cilësor të bletës për zhvillimin e biznesit të tyre, punësimin e punëtorëve të rinj dhe rritjen e konkurrueshmërisë.

Kryetari i Shoqatës së Bletarëve "Nukleus", **Mladen Djokic**, theksoi se bletarët me anë të makinerive të reja do të prodhojnë dyll të cilësisë së lartë.

”

**Prapa nesh gjendet e tërë makineria që na mundëson sterilizimin e dyllit tonë dhe prodhimin e përbërësit të nevojshëm dhe të vetëm që e përdorin bletët, e ky është dylli. Kjo makineri nuk do të jetë në shërbim vetëm të bletarëve lokalë, por gjithashtu edhe të bletarëve në komunën e Graçanicës dhe më gjerë”,**

nënvizoi Djokic.

Ndonëse është relativisht i ri në këtë biznes, **Sinisa Djordjevic** nga Graçanica zotëron 40 koshere bletësh. Plani i tij, thekson ai, është të realizojë gjithsej 100 koshere bletësh.

”

**Më herët kemi blerë gjithçka dhe çdo gjë, dyll dhe parafinë me cilësi të dyshimtë. Ua ofrojmë bletëve në koshere, mirëpo bletët thjesht nuk e pranojnë, dhe gjithashtu nuk e nxjerrin kornizën ku e ruajnë ushqimin dhe pjellën. Prandaj, kjo makinë vërtetë do të thotë shumë për neve,**”

tha Sinisa Djordjevic.

**Zivorad Petkovic**, një ndër bletarët më me përvojë, tha se është e rëndësishme që tani posedojnë dyll cilësor të bletëve afër shtëpisë.

”

**Produkti më i shtrenjtë për bletarët është koha. Është dashur të shkonim në vende shumë të largëta për të blerë dyll të cilësisë së mirë. Kemi vizituar panairë rajonale në Beograd, Shkup, Nish, madje edhe atje ishte e vështirë që të gjejmë cilësinë e fletëve të dyllit të bletës, e mos të flasim për kohën e shpenzuar për transport. Unë jam gjithashtu i lumtur që ne si brez më me përvojë mund t'u ofrojmë njohuri të rinjve, të cilët janë energjikë dhe të gatshëm për të përmirësuar gjërat ekzistuese. Deri më tani është duke funksionuar shumë mirë.**”

Komuna e Graçanicës ka kontribuar gjithashtu në masë të madhe – duke ia siguruar Nukleus-it hapësirat pa pagesë, të cilat mund t'i shfrytëzojnë për të prodhuar dyll të bletës. Kryetari i Graçanicës, **Srdjan Popovic**, ka falenderuar projektin EYE në kuadër të SDC-së dhe qeverinë e Zvicrës për investimin, duke vënë në dukje se funksionimi i Shoqatës “Nukleus” është shumë i rëndësishëm për këtë komunë.

”

**Ekzistojnë mbi 100 bletarë në territorin e komunës së Graçanicës, posedojmë rreth 3,000 koshere bletësh dhe kjo vërtetë na bën të lumtur: fakti se njerëzit mund të jetojnë nga ajo që e prodhojnë vetë. Ky është një sinjal për të gjithë të rinjtë që kanë ide inovative dhe gjithë të tjerët që punojnë në sektorin e punësimit të rinjve, Komuna do t'i takojë ata,**”

theksoi Popovic.



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development  
and Cooperation SDC

**EYE**

Enhancing Youth  
Employment

## 2.




## HAPET QENDRA E RE E KARRIERË NË VITI si rezultat i bashkë-investimit midis SDC dhe Komunës së Vitisë



Dje patëm kënaqësinë të shënojme përfundimin e një qendre të re të karrierës në shkollën Jonuz Zejnullahu në Viti, e bërë e mundur si rezultat i një bashkë-investimi midis SDC, EYE dhe Komunës së Vitisë.



### KJO QENDËR E KARRIERËS DO TË KËSHILLOJË QINDRA NXËNËS



Do të ndërmjetësojë punësimin, dhe gradualisht do të kontribuojë në adresimin e mospërputhjes së aftësive që ka qenë sfida më e madhe për tregun e punës në Kosovë. Në vitin 2020, ndërsa përhapej pandemia, studentët në të gjithë Kosovën u gjendën në një situatë të paprecedentë, dhe kalimi i tyre nga shkolla në punë u bë veçanërisht sfidues pasi tregu i punës përjetoi ndryshime të mëdha. Ky vit na ka treguar se tani, më shumë se kurrë, udhëzimi për karrierë është shumë i nevojshëm.

Na duhen qendra karriere për t'i mësuar studentët se si të përshtaten me pasigurinë e vitit 2020, për të ndërtuar besimin dhe për t'i fuqizuar ata, për t'i identifikuar aftësitë e tyre, për të lehtësuar punësimin dhe për t'i pajisur ata me aftësi për të kuptuar më mirë botën e punës. Për arsimin dhe aftësimin profesional, udhëzimi në karrierë është veçanërisht i rëndësishëm pasi përmirëson efikasitetin e arsimit, forcon lidhjet me tregun e punës dhe sektorin privat, dhe rrit regjistrimin.

Së bashku me një sërë partnerësh lokalë siç është AVETAE, ne tashmë kemi krijuar qendra të karrierës në 8 shkolla të arsimit profesional në të gjithë Kosovën. Kjo do të jetë qendra e 9-të dhe ne shpresojmë që ky model të bindë shkollat dhe komunat e tjera që të hyjnë në një bashkëpunim të ngjashëm për ofrimin e udhëzimeve në karrierë, edhe pa fonde të jashtme.

## 3.



### 'SHKOLLA DIGJITALE' NGA KOSOVA NËNSHKRUAN MARRËVESHJE ME 'BERLITZ',

një ndër shkollat më të mëdha të gjuhëve në botë, me mundësi të zgjerimit në 500 lokacione të reja në mbarë botën.



Jemi mësuar të dëgjojmë se si kompanitë e TIK-ut në Kosovë i përvetësojnë shërbimet dhe standardet globale. Mirëpo, janë të paktë shembujt e kompanive kosovare që eksportojnë shërbime në mbarë botën. Tani, përmes marrëveshjes së nënshkruar së fundi, Shkolla Digjitale do ta zgjerojë arsimin e tyre teknologjik për fëmijë në 500 lokacione të reja potenciale - nga Hong Kongu dhe Gjermania, deri në SHBA, Meksikë dhe gjetiu.



**Ekziston një ndjenjë shumë e madhe e krenarisë në ekipin tonë - filluam me diçka shumë të vogël në Prishtinë, që tani është duke ndikuar tek të rinjtë në mbarë botën."**

thotë **Hana Qerimi**, bashkëthemeluese e Shkollës Digjitale. "Gjithçka akoma duket paksa e pabesueshme - filloi vetëm nga një bisedë, e tani jemi duke vepruar në caq shumë vende. Është nevojitur hulumtim, punë, përkushtim dhe këmbëngulje e madhe për të arritur këtë, teksa jemi duke punuar gjatë gjithë kohës për t'ia bërë me dije botës se të gjithë kosovarët janë të zellshëm, e jo vetëm shkolla digjitale!"



**Kontrata e re me gjigantin global të kurseve Berlitz US** do të mundësojë që plan-programet dhe trajnimet e arsimit teknologjik për fëmijët e Shkollës Digjitale të zhvillohen në më shumë se 500 lokacione ekzistuese të Berlitz. Berlitz është një institucion i fuqishëm global i arsimit teknologjik, që u mundëson të rinjve të shqyrtojnë transformimin digjital dhe të përfitojnë nga mundësitë që u ofron e ardhmja.

EYE bëri një investim të planifikuar në Shkollën Digjitale për të përmirësuar marketingun dhe brendimin, si dhe për t'i ndihmuar atyre të paraqesin markën dhe shërbimet në nivel ndërkombëtar. Fusha e TIK-ut në Kosovë ka një potencial të madh: ndoshta është një ndër sektorët e paktë që ka bilanc pozitiv tregtar, ku vlera e eksportit në vend është më e lartë sesa ajo e importit. Kjo mund të nxisë zhvillimin ekonomik dhe të krijojë mijëra vende të reja të punës.

# Nga fillimet modeste deri tek rritja globale

Shkolla Digjitale është një biznes me lokacion në Kosovë që u ofron fëmijëve dhe të rinjve kurse të programimit dhe të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit. Është një program që ofrohet pas orarit të punës, të cilin e kanë themeluar Hana Qerimi dhe Darsej Rizaj, dy entuziastë kosovarë të biznesit dhe teknologjisë, vizioni i të cilëve ishte që të rinjtë kosovarë t'i përvetësojnë shkathtësitë e duhura për të pasur sukses në jetë dhe punë. Kompania tashmë ka trajnuar qindra të rinj në Kosovë në programet HTML, CSS, Javascript dhe në shkathtësitë tjera digjitale.

Pas zgjerimit në nivel lokal, Shkolla Digjitale hapi franchise-in e tyre të parë në Slloveni, në vitin 2018, duke krijuar kështu një histori të madhe të suksesit, e cila do t'i hapte dyert për zgjerim të mëtejshëm. Maqedonia dhe Bosnja i ndoqën shpejt ata, gjë që e shtyu ekipin të fillojë me përfshirjen e mësimdhënies së gjuhës në programet e tyre të teknologjisë.



**"Në ditët e sotme, të rinjtë mësojnë gjuhën e programimit përmes teknologjisë, prandaj filluam ta kombinojmë atë në programet mësimore,"** thotë Hana. "Në këtë mënyrë kemi rënë në kontakt me Berlitz US dhe pas disa telefonatave, drejtori i Berlitz për rajonin EMEA erdhi për të na vizituar në Prishtinë." Shumë shpejt filluan fazat e pilotimit në Gjermani, kryesisht në Berlin, Frankfurt, Erfurt dhe Dresden – të gjitha duke u shndërruar në një sukses.

Përdërisa pandemia përhapej dhe shtetet tjera gjendeshin të bllokuara, Shkolla Digjitale – me një ekip mjaft të zhdërvjellët – zhvilloi programe dhe sisteme të reja të menaxhimit duke përshtatur shpejt modulet e tyre për mësimnxënien online. Me sistemet e reja të mësimnxënies, të cilat u dëshmuar si të suksesshme në Kosovë, Berlitz identifikoi potencialin e tij për t'u zhvilluar në nivel global, me ç'rast pasoi marrëveshja për të filluar mesimdhënien online në SHBA, Meksikë, Hong Kong dhe vende tjera.

Kjo mundësoi që plan-programet mësimore të arsimit teknologjik për fëmijët e Shkollës Digjitale të zhvillohen në më shumë se 500 lokacione ekzistuese të Berlitz. Do të organizohen trajnime personale dhe digjitale, ndërsa Shkolla Digjitale planifikon të mbështesë rritjen duke i ofruar mbështetje ekipit të tyre për zhvillimin e plan-programeve mësimore, ekipit për mbështetjen teknike dhe ekipit për marketing dhe shitje.

"Aktualisht programimi është puna që më së shumti kërkohet, ndërsa ajo që ne jemi duke ofruar do të ndikojë në masë të madhe tek fëmijët dhe të rinjtë në mbarë botën," thotë Hana. "Gjithashtu presim që të fillojmë bashkëpunimin me shkollat publike dhe t'i mbështesim ato që të jenë në hap me trendet e reja dhe përparimet teknologjike në fushën e mësimdhënies".

Investimet e synuara në ofruesit e zhdërvjellët dhe të aftë në fushën e trajnimit teknologjik, siç tregohet edhe më lart, krijojnë lidhshmëri dhe mbështesin digjitalizimin e ekonomisë më të gjerë. Në vitin 2020, aftësia për të ofruar qasje në trajnimin modular dhe fleksibil përmes digjitalizimit dhe mësimnxënies së kombinuar është thelbësore për të siguruar qëndrueshmëri afatgjatë. Nxitja e zhvillimit të aftësive gjithëpërfshirëse është jetike për punën që EYE është duke e kryer në Kosovë, që t'u mundësojë të rinjve të përvetësojnë shkathtësitë e kërkuara, të cilat shpiejnë deri tek mundësitë më të mira të punësimit.

**Shkolla Digjitale është shembulli më i mirë se si një investim sistematik mund të ketë sukses të konsiderueshëm, dhe jo vetëm të ndryshojë perspektivën e të mësuarit digjital në Kosovë, por gjithashtu të plasojë bizneset lokale në nivel global dhe të ndikojë në qasjet globale ndaj arsimit joformal.**

## 4.



### RIMËKËMBJA NGA PANDEMIA: Si po i përgatit furgoni i improvizuar salduesit e ardhshëm në Kosovë



Ndërsa sektori i përpunimit të metalit në Kosovë ballafaqohet me pasojat e COVID-19, projekti EYE i SDC-së ndihmon në krijimin e projekteve inovative dhe produktive të trajnimit dhe certifikimit në sektorin e saldimit, të cilat parashikohen ta ndihmojnë industrinë e saldimit që të avancojë përtej pengesave të COVID-19, të punësojë staf të kualifikuar dhe të përmirësojë fleksibilitetin e firmave prodhuese.



### Kosova ka histori të gjatë në përpunimin e metalit.

Ndërmarrjet e mëdha shoqërore të cilat dikur përfaqësonin shtyllën e ekonomisë së këtij vendi të vogël, tani u kanë lënë vendin kompanive më të vogla të privatizuara të cilat eksportojnë produkte metalike në tregjet evropiane, siç janë metalet bazike, çeliku strukturor dhe pajisjet e sistemit të ngrohjes dhe ventilimit.

Megjithatë, pavarësisht potencialit të madh të industrisë metalike për nxitjen e zhvillimit ekonomik në Kosovë dhe përkundër kërkesës gjithnjë në rritje për punëtorë në këtë sektor, ende ekziston një mungesë e madhe e saldatorëve të kualifikuar. Madje, edhe me një papunësi të madhe në Kosovë, veçanërisht në mesin e të rinjve – prej të cilëve 49% janë të papunë – prap është e vështirë gjetja e saldatorëve me aftësi adekuate .

Arsyet janë të shumta, por ato mund të përmbledhen në disa fakte: institucionet dhe kompanitë që ofrojnë trajnime akoma nuk komunikojnë mjaftueshëm me njëra-tjetrën, shumica e ofruesve të trajnimit ende nuk ofrojnë shërbime që pëfshijnë certifikime të njohura ndërkombëtarisht, ndërsa ekziston një mungesë e përgjithshme e informacionit mbi tregun rreth profesionit dhe trajnimeve në sektorin e saldimit.

Duke qenë se COVID-19 depërtoi anembanë Kosovës, kjo e çrregulloi në masë të madhe tregun e punës, i cili në Kosovë veçse është i brishtë. Industria e saldimit – sikurse edhe shumica e industrive tjera – u godit rëndë, ndërsa mundësia për të gjetur punonjës të kualifikuar u bë edhe më e vështirë.

### Mbështetja e zgjidhjeve të pashembullta për kohëra të pashembullta

Ofruesit e trajnimeve inovative nuk qëndruan duarkryq. Shumica prej tyre janë duke gjetur mënyra kreative për t'u përshtatur me situatën. Mirëpo, një kompani, e quajtur Weld Tech, ishte veçanërisht imagjinare – në disa mënyra që Kosova më herët ndoshta kurrë nuk i kishte parë. Çfarë ishte zgjidhja e Weld Tech? Një furgon i improvizuar gjenial që u shndërrua në hapësirë mobile për trajnim në saldim, që bazohet në ISO, me teknologjinë më të avancuar!

”

## COVID-19 KA KRIJUAR NJË SITUATË TË VËSHITRË, DUKE ÇUAR NË KUFIZIME TË UDHËTIMIT PËR PERSONELIN E KOMPANIVË, THOTË EKREM SALLAHAJ, PRONAR I WELD TECH.

I cili është gjithashtu specialist ndërkombëtar i saldimit dhe inxhinier i ndërtimit. “Kompanitë e përpunimit të metalit kanë gjithashtu dinamika të ndjeshme të punës, prandaj, nuk është e pazakontë që kompanitë ngurrojnë t’i dërgojnë saldatorët e tyre në trajnime dhe certifikime, për shkak të orarit të ngjeshur të punës. Për këtë arsye kemi sajuar shërbimin e trajnimit mobil, i cili merr në konsideratë të dyja këto dinamika.” Trajnimi mobil i Weld Tech zhvillohet krejtësisht brenda furgonit, hapësirat e brendshme të të cilit janë ridizajnuar plotësisht për të ofruar trajnime të saldimit brenda kompanisë, duke ia kursyer personelit të kompanisë kohën e çmuar të udhëtimit dhe duke ia mundësuar të kthehen në prodhim pasi të kenë përfunduar trajnimin. Furgoni modest udhëton në mbarë Kosovën duke ofruar trajnim për të gjithë personat që synojnë një gjë të tillë, të gjitha me komoditet në vendin e tyre të punës.

”

## NE JEMI E VETMJA QENDËR E TRAJNIMIT NË KOSOVË QË OFRON TRAJNIME DHE CERTIFIKIME TË BAZUARA NË ISO, NË BASHKËPUNIM ME TUV RHEINLAND”, POHON EKREMI.”

“Deri më tani kemi trajnuar mbi 30 kandidatë, shumica prej të cilëve janë certifikuar me IS 9606.” Ekremi thekson se të trajnuarit po i përgjigjen në mënyrë pozitive furgonit. “Pjesëmarrësit që marrim pjesë në trajnime kanë sfonde dhe profesione të ndryshme. Ata ndjehen komod gjatë punës brenda furgonit – është një hapësirë kompakte që u ofron një ndjenjë të shkëlqyeshme të avancimit të vërtetë të teknikave të tyre të saldimit. Saldimi është gjithashtu shumë i kërkuar dhe ka interesim të konsiderueshëm, teksa njerëzit nuk ngurrojnë të paguajnë dhe të marrin pjesë.” Në afërsi të fshatit që gjendet afër qytetit të vogël të Kosovës, Suharekës,



Driton Kacaniku, një 20-vjeçar i diplomuar në trajnimin e saldimit, i cili vjen nga fshati i vogël i Dubravës, është duke bashkuar me kujdes pjesët metalike dhe lustruar sipërfaqet metalike. Pasi bën pushim nga puna për të na përshëndetur, na tregon se trajnimi e frymëzoi atë të ndiqte karrierën në industrinë e saldimit. “Trajnimi për saldimit më mundësoi të mësoj teorinë dhe praktikën, ndërsa në fund edhe u certifikova”, thekson Dritoni. “Shkathtësitë e përvetësuara më kanë ndihmuar të gjej punë, e kur mbarova trajnimin fillova të punoj këtu në kompaninë [Ndertuesi shpk], e cila ma mundësoi që të marr pjesë në trajnim. “Tani jam i lumtur kur çdo mëngjes udhëtoj për të shkuar në punë dhe dëshiroj që saldimit të jetë profesioni im.”

## WELD TECH ËSHTË ANËTAR I KLLASTERIT TË INDUSTRIJË SË METALIT DHE ENERGJISË SË RIPËRTËRITSHME TË KOSOVËS (KIMERK)

i cili posedon një rrjet gjigant të bizneseve që operojnë në industrinë metalike, e që ndihmojnë Weld Tech-un të sigurojë pjesëmarrës të rinj dhe ndërveprojë me palët e interesuara. KIMERK gjithashtu avokon për profesionin e saldimit, duke ngritur vetëdijen në lidhje me përfitimin nga ky profesion, kërkesën e tregut dhe qëndrueshmërinë si zgjedhje të karrierës.



## Gjatë viteve të fundit, industria metalike në Kosovë ka evoluar në masë të madhe,

Teksa janë paraqitur standarde të reja të cilësisë, ndër të cilat EN 1090 është një nga më të rëndësishmet," thotë Astrit Rexhaj, Drejtori Ekzekutiv i KIMERK-ut. "EN 1090 është një standard i detyrueshëm për kompanitë eksportuese që synojnë tregje të reja në Bashkimin Evropian, e për ta siguruar këtë, kompanitë duhet të kenë saldatorë të certifikuar."

Astriti pohon se duke qenë i vetëdijshëm për këto kriteret dhe përpjekje të kompanive anëtare të KIMERK-ut, për t'u plasuar në tregun ndërkombëtar, fokusi i veçantë duhet të vendoset tek mbështetja e certifikimeve. "Me mbështetjen e SDC-së, përmes projektit EYE, si dhe GIZ, kemi certifikuar më shumë se 100 saldatorë me EN ISO 9606," nënvizon ai.

Mirëpo, në vitin 2020, kur qeveria filloi të zbatonte masat e distancimit social për të frenuar përhapjen e COVID-19, u paraqitën sfidat e reja të logjistikës, sigurimi i udhëtimit dhe vendeve për pjesëmarrësit u bë gjithnjë e më i vështirë, e kur kompanitë e prodhimit siguruan hapësirat e tyre për trajnime, procesi i mësimnxënies ra ndesh me proceset e prodhimit duke krijuar shqetësim tek punonjësit tjerë. Aparatet e saldimit janë gjithashtu të shtrenjta dhe kompanitë ngurruan t'i marrin ato me qira për qëllime të trajnimit.

Kështu, Weld Tech sajoi idenë për të krijuar një qendër mobile të trajnimit, e cila do të mund të ofronte trajnim për saldatorët anembanë Kosovës. "Në kuadër të industrisë sonë, ky është një ndër projektet më inovative, dhe mund të them pa ngurrim se ky është një ndër projektet më të rëndësishme për industrinë metalike, duke ofruar trajnim fleksibil dhe zgjidhje në certifikim, si rrjedhojë, kjo do t'u ndihmojë kompanive që të avancojnë shkathtësitë e punonjësve të tyre dhe të zgjerohen në tregun ndërkombëtar", nënvizon Astriti.

Projekti EYE në kuadër të SDC-së, vitin e kaluar ka lidhur partneritet me KIMERK-un, si pjesë e qëllimeve tona afatgjata për zhvillimin sistematik të partneriteteve afatgjata me sektorin privat, për të mbështetur mundësitë e punësimit dhe facilituar tranzicionin e tregut të punës.

## Tek projekti EYE, ne kishim identifikuar potencialin e madh të Weld Tech-ut

Mirëpo ky ishte një biznes fillestar që nuk kishte mjete për të investuar tërësisht në projektin e tyre të trajnimit mobil. Kemi mbështetur Weld Tech-un duke e pajisur furgonin me pajisje më të avancuara, pajisje mbrojtëse dhe materiale industriale, në mënyrë që pjesëmarrësve t'u ofrohet trajnim sa më i mirë. Tani, po i ndihmojmë atyre të prezantojnë dy trajnime të reja në inspektimin vizual dhe testimin e saldimit pa dëmtimin e materialit - shërbime të cilat kompanitë vendore të përpunimit të metalit deri më tani u duhej të importonin nga jashtë.

**"Mbështetja e SDC-së ishte vendimtare për t'u përshtatur me COVID-19 dhe për të krijuar shërbimin tonë të trajnimit mobil", thotë Ekremi, pronar i Weld Tech-ut.**

"Ballafaqimi me pandeminë nuk ishte i lehtë. Ndihma e SDC-së & EYE ishte e rëndësishme për Weld Tech-un dhe ne jemi shumë falenderues për këtë. Tani, po planifikojmë t'i zhvillojmë shkathtësitë tona në një të ardhme të afërt, duke shpresuar se do të arrijmë të punësojmë më shumë personel dhe të ofrojmë më shumë trajnime."